



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.132/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Nenad Lazic dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit të kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, në objekt privat, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.132/2019 e datës 29.09.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë,

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 27 Shtator 2019 rreth orës 18:00, zyrtarë të shtabit zgjedhor të LDK-së, kanë vërejtur dhe fotografuar vendosjen e një foto-posteri të kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, ngjitur apo pranë Zyrës së Shtabit Zgjedhor të LDK-së, që përndryshe është banesë kolektive, në pronësi private, për çka LDK, ka marrë vesh se subjekti PDK, nuk e ka marrë pëlqimin e pronarit, ngase subjekti LDK, në këto hapësira ka lokalitetin e zyrës për të cilin paguan qira mujore, kurse për vendosje të këtij posterit PDK, ka vepruar pa leje dhe pa pëlqim të pronarit.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 33 pika b i LZP-së, dhe me rregullat zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuar dhe një kopje të kontratës për hapësirë reklamuese.

Në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2019, subjekti politik PDK, thekson se shkelja nuk është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosove, se vendosja është bërë me pëlqimin e kompanisë “Selmans Network”, qiramarrësi i cili posedon edhe kontratën e kësaj ndërtese mbi qiranë. Më tutje thekson se përfaqësuesi i kompanisë në fjale shpreh pëlqimin në ane gojore për vendosjen e këtij posterit, duke deklaruar se merr përsipër të gjitha përgjegjësitë, sepse dhe objekti i kësaj kontrate është marrja e murit të jashtëm të objektit që tregohet në foton e bashkangjitur.

Përgjigjes në ankesë i ka kontratën për hapësirë reklamuese të kompanisë në fjale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi posteri i kryetarit të subjektit politik PDK, Kadri Veseli, është i vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterave.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje kundërshtim me nenin 33 pika b i LZP-së, dhe me rregullat zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013, nga ana e subjektit politik PDK, pasi që posteri në fjalë është i vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, në hapësire reklamuese në objektin në fjalë, ashtu siç vërtetohet edhe nga fotografia e bashkangjitur nga palët e të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr.132/2019 më datën 02.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.